



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-091

Prishtinë, më 28 janar 2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 28 JANAR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23 janar 2013,
2. Vazhdimi i mbledhjes plenare,
3. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 janar 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 janar 2013.

2. Vazhdimi i mbledhjes plenare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vazhdimin e mbledhjes plenare, të filluar më 21 janar 2013, vendosi që kjo mbledhje plenare e Kuvendit t'i vazhdojë punimet të mërkurën, më 30 janar 2013, me këtë:

R e n d d i t e

1. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
2. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

3. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 31 janar 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e katërt të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për turizmin,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transportin rrugor,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për produktet e ndërtimit,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për planifikimin hapësinor,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për administrimin e punës në zyrë,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tarifatat e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë,
19. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Avokatin e Popullit,
20. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për zgjedhjen e një gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese,
21. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për zgjedhjen e një anëtarit joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
22. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtarit në Komisionin për Punë të Jashtme.

4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarët e tyre

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me projektligjin e lartshënuar, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision Funkcional, dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision i përhershëm, që ta shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarët e tyre, bashkë me mendimin e Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin preliminar për shqyrtimin e parë të tij.

2. Projektligji t'u shpërndahet të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Shqyrtimi i propozimit për formimin e grupeve të miqësisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që, mbi bazën e propozimit për formimin e dhjetë (10) grupeve të miqësisë, t'i propozojnë anëtarët për secilin grup të miqësisë të Kuvendit të Republikës së Kosovës me parlamentet e shteteve të tjera.

Nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, si dhe kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Albin Kurti, dhe kryetari i Komisionit për Integritet Evropian, Lutfi Haziri, t'i shqyrtojnë propozimet e grupeve parlamentare dhe Kryesisë së Kuvendit t'ia paraqesin propozimin përfundimtar për miratim në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Bekim Haxhiu, i mbështetur edhe nga 19 deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me gjendjen e sportit në Kosovë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që për këtë çështje të veprohet për procedim të mëtejshëm sipas Rregullores së Kuvendit.

4. Kërkesa e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me mospërbushjen e vendimit të Kuvendit të Kosovës nga Radiotelevizioni i Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës që në bazë të vendimit të Kuvendit, nr. 04-V-147, të datës 29 korrik 2011, Kuvendit t’ia paraqesë raportin lidhur me të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

2. Raporti duhet t’i parashtrohet Kuvendit në afatin prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij përfundimi.

* * *

Kryetari i G/P të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, e shtroi para anëtarëve të Kryesisë çështjen e zgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm të Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me çështjen e lartshënuar, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision FunkSIONAL, që ta shqyrtojë çështjen e zgjedhjes së drejtorit të përgjithshëm të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit, nëpërmjet Kryesisë, t’ia paraqesin raportin.

5. Njoftimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Punë të Jashtme

Kryesia, propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Punë të Jashtme e radhiti në rend dite për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 31 janar 2013.

Pika shitesë:

1. Shkresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për kompletimin e CV-ve të kandidatëve të propozuar për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me shkresën e lartshënuar, e nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funkcional, që t'i rishikojë CV-të e kompletuara për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Të ndryshme:

1. Njoftimi i kryetares së G/P “6+”, Myfera Shinik lidhur me ndërrimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit

Kryetarja e G/P “6+”, Myfera Shinik, e njoftoi Kryesinë e Kuvendit me propozimin për ndërrimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit nga radhët e këtij grupi me rotacion, sipas marrëveshjes së brendshme të tyre.

Kryesia propozimin e lartshënuar e shtyu për mbledhjen e radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale